

VENDIM
Nr. 1395, datë 9.10.2025

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, Z. BESNIK XHEMAL BRAHIMI, KANDIDAT I LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALDEMOKRATE, QARKU SHKODËR, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ 2025

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 3, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2408/1 prot., datë 15.9.2025, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar për shkak të dorëheqjes së deputetit, z. Tom Gjek Doshi, i zgjedhur në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i propozuar nga “Partia Socialdemokrate”.

Partia Socialdemokrate, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 177, datë 25.2.2025.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 34, datë 28.8.2025, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të zhvilluara në datë 11.5.2025.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 1340, datë 27.6.2025, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialdemokrate, për zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 11 Maj 2025, ka fituar 2 (dy) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 1340, datë 27.6.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar shpërndarja e mandateve midis subjekteve zgjedhore si dhe përcaktimi i kandidatëve fitues në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025.

Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 01 (një), në listën me parapëlqim, z. Besnik Xhemal Brahimi.

Me shkresën nr. 6245 prot., datë 30.9.2025, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, z. Besnik Xhemal Brahimi, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Besnik Xhemal Brahimi, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 24087 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent

për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për z. Besnik Xhemal Brahimi, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Besnik Xhemal Brahimi.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Besnik Xhemal Brahimi, ku konstatohet se kandidati në fjalë rezulton i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të keut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Besnik Xhemal Brahimi, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Tom Gjek Doshi, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 01 (një), në listën me parapëlqim, z. Besnik Xhemal Brahimi.

PËR KËTO ARSYE,

bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 3, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, në zonën zgjedhore qarku Shkodër, z. Besnik Xhemal Brahimi.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi